



Më 05 - M - 2018 NË EMËR TË POPULLIT
Dana

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM

DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri si dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në lëndën penale kundër të akuzuarve [REDACTED]

[REDACTED] dhe [REDACTED], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si dhe të pandehurit

[REDACTED] për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/I.I. nr.1692-1/14 të datës 23.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor, në prezencën e prokurorit të shtetit Mimoza Syla, të dëmtuarit [REDACTED], të pandehurit [REDACTED] dhe mbrojtësit të tij me autorizim avokatit [REDACTED], si dhe të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] me datë 25.01.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I

Të akuzuarit:

1. [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Shtime, i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] i pa martuar, ka të kryer fakultetin ekonomik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDACTED].
- 2. [REDACTED], nga Shtimja, rr. [REDACTED], i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i martuar, punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse me datën 16.06.2014, reth orës 20.30, në kafiterinë "Muli" në Shtime, pasi që i pandehuri [REDACTED] ishte takuar me shokët e vet të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] [REDACTED] së bashku ishin marr vesh që ta rrahin të dëmtuarin [REDACTED] pasi që me [REDACTED] ditë më pare kishte pasur një grindje e atë ditë kishin vendosur të hakmerren ndaj tij dhe aty që të tre së bashku shkojnë në lokalini e bilardos "24 orë", ku ishte i dëmtuari e pasi [REDACTED] e thërret të del jashtë, posa i dëmtuari del jashtë lokalit, i pandehuri i pare [REDACTED] e godet me grushte në fytyrë, ndërsa i pandehuri i dytë [REDACTED] të njëjtin e godet me kokë në hundë, me çrast i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta të regjionit të hundës me gjakderdhje nga vrimat e hundës dhe thyrje e kockës së hundës së shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të forte mbrehtës (j o mprehtë, i topitur) me pasoja të përkohshme për shëndetin të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të datës 07.11.2015.

- me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4,7,17,21,41,42,43,46, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurit i:

GJY KON

1. Të akuzuarin [REDACTED] me dënim në gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
2. Të akuzuarin [REDACTED] me dënim në gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimet me gjobë nuk mund të ekzekutohen as në mënyra tjera të parapara me nenin 46 të KPRK-së, do të ekzekutohen në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) euro, të pandehurit do të vuajnë një ditë burgu.

I dëmtuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Shtime, ka hek dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Obligohen i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili vç e vç të paguaj shumën prej 30 /tridhjeta/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II

Ndaj të akuzuarit,

[REDACTED], nga Shtimja, rr. [REDACTED], i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i martuar, me profesion shofer, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.përsoneal [REDACTED]

Në kuptim të nenit 363 par.1 pikë 1.1 të KPPK-së,

REFUZOHEȚ AKUZA

Sepse me datë, vend dhe kohë të si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, i pandehuri e ka kanosur të dëmtuarin [REDACTED], duke i thënë se “pse e ke ngucur [REDACTED] a e din se të grijë me sëpate dhe ta ndaloj Shtimen” me çraست tek i dëmtuari kjo kanosje ka shkaktuar shqetësim dhe frikë.

Me që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza për veprën penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së ndaj të pandehurit [REDACTED], pasi që i dëmtuari [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor a ka dekluaruar se e tërheq propozimin për ndjekje penale ndaj të pandehurit [REDACTED].

I dëmtuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Shtime, ka hek dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Shpenzimet e procedurës penale biejn në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m i

I

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.1962-1/14 të dt.23.11.2015 e ka ngarkuar të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si dhe të pandehurit [REDACTED] për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësore, në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit në fillim të shqyrtimit gjyqësor lexoi aktin akuzues, ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit mbeti në tërësi pranë aktit dhe kualifikimit juridik të tij sa i përket të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED], duke kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe ti përcaktohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Të akuzuarit [REDACTED] konform nenit 325 të KPPK-së në shqyrtimin gjyqësor i është dhënë mundësia për tu deklaruar lidhur me fajësinë, ku i njëjtë ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilat ngarkohet, i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar me [REDACTED] ku kanë punuar së bashku në kompaninë Agrocop në Petrovë dhe nga aty ata kanë pasur një mosmarrëveshje mes vete. Ndërsa ditën kritike kur ka ndodhur rasti ka deklaruar se ka qenë në Shtime duke shëtitur, ndërsa i pandehuri nga internet kafe kati i dytë me ka kapur përfyt duke më goditur, ndërsa ka deklaruar se po ashtu edhe ai ja ka kthyer të dëmtuarit [REDACTED] I pandehuri [REDACTED] ka deklaruar se [REDACTED] për herë të parë e ka parë atë ditë aty sepse me herët ka deklaruar se nuk e ka njojur, ndërsa ka deklaruar se i pandehuri [REDACTED] ka hyrë përf të na ndarë. I pandehuri [REDACTED] ka deklaruar e ka parë se i ka rrjedhur gjak nga hunda por ka deklaruar se i dëmtuari e ka pasur hundën e lënduar më herët pasi ka pasur aksidente më herët në fshatin Petrovë komuna Shtime.

I akuzuari [REDACTED] në mbrojtjen e tij ka deklaruar se data nuk i kujtohet por e di që ka qenë pas dite ora 16.00, deri sa ka qenë duke pirë kafe në kafiteri se bashku me [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe një person tjetër [REDACTED] dhe pasi që kanë pirë kafe kanë dalur nga kafiteria për tu shëtitur, aty i pandehuri [REDACTED] afér një butiku ka deklaruar se e ka parë të dëmtuarin [REDACTED] duke qëndruar tek internet kafeja "24 orë" në katin e dytë në Shtime, aty [REDACTED] tha se a po vjen me mua se kam për të biseduar diçka me [REDACTED] pasi që kam pasur një problem me të dhe pasi që ishim bashk shkuam atje për të biseduar dhe aty [REDACTED] nga poshtë e thirri [REDACTED] të zbresë poshtë nga kati i dytë dhe menjëherë [REDACTED] i tha [REDACTED] se a të kujtohet problem që kemi pasur më herët dhe menjëherë [REDACTED] e goditi [REDACTED] me grushte në fytyrë. I pandehuri [REDACTED] pastaj ka deklaruar se aty ka ndërhyrë në mes për të ndarë dhe pastaj ka deklaruar se i ka bërtitur [REDACTED] se përse nuk me ke treguar me heret se po ta dija nuk kisha shkuar dhe e kam shtyrë [REDACTED] mbrapa dhe ka deklaruar se e ka kapur [REDACTED] dhe pa dashje duke e shtyre e ka goditë me kokë.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetoj gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarit – të dëmtuarit [REDACTED] i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se data saktë nuk i kujtohet, mirëpo e din që kur ka ndodhur ky rast ka qenë rrëth orës së mbrëmjes në një lokal në Shtime. I dëmtuari ka deklaruar se me të pandehurin [REDACTED] ka pasur probleme edhe më herët dhe atë deri sa ka qenë duke punuar së bashku në një mobilieri, ku ka deklaruar se e kishte shtyrë dhe ka qenë duke rënë në sharrë. I dëmtuari ka deklaruar ditën kur ka ndodhur rasti ka qenë në internet kafe në Shtime në katin e dytë dhe aty nga poshtë ka deklaruar se e kishte thirre i pandehuri [REDACTED], i cili kishte qenë së bashku me [REDACTED] dhe [REDACTED] I dëmtuari ka deklaruar se kur ka zbritur poshtë se pari kam filluar të flasë me [REDACTED], i cili me tha se pse e ke nguc [REDACTED] ndërsa unë i thash se e kam përfunduar me [REDACTED] dhe nuk dua më të bisedoj për këtë punë dhe në ato fjalë deri sa kam qenë duke biseduar me [REDACTED] i dëmtuari ka deklaruar se ka ndërhyrë [REDACTED] dhe e ka goditur me grushte në pjesën e fytyrës, i dëmtuari ka deklaruar se ka dashur që t'ia kthej [REDACTED] në të njëjtën mënyrë por aty ka ndërhyrë [REDACTED] dhe me ka kapur me duar dhe më ka goditur me kokë në hundë ku edhe ka filluar të më rrjedh gjak nga hunda.

Gjykata dëshmitë e të dëmtuarit [REDACTED] e ka vlerësuar si të besueshme, objektive dhe reale, pasi qe e njëjtë gjejë mbështetje edhe në provat tjera materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor siq janë ekspertiza mjeko ligjore me nr.reference 022015 dt.07.11.2015 nga eksperti mjeko ligjor dr. [REDACTED], raporti mjekësor nga Qendra e Mjekësisë Familjare dr. [REDACTED] në Shtime e dt.16.06.2014, raporti mjekësor i dt.16.06.2014 e lëshuar nga Qendra Emergjente në Ferizaj me nr.protokolli 587, raporti mjekësor i lëshuar nga QKUK në Prishtinë instituti i Radiologjisë i dt.17.06.2017 si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata vlerësoi edhe e mori në konsideratë edhe mbrojtjen e të akuzuarit [REDACTED] mirëpo gjykata një mbrojtjes së tillë nuk e vlerësoi si të besueshme, sepse mbrojtja e të pandehurit është kontradiktore, sidomos me deklaratën e tij të dhënë në procedurën paraprake me dt.30.06.2014, i cili në këtë deklaratë kishte deklaruar se me datë 16.06.2014 vendosa të shkoj te bilardo te ish internet kafeja 24 orë në Shtime aty qëndronte zakonisht [REDACTED] dhe ta frikësoja, rrëth orës 20.00 ka shkuar të bilardo dhe aty e kam thirre [REDACTED] që të dilte jashtë bilardos dhe kur ka dal jashtë menjëherë e kam goditur disa here me shuplaka në fytyrë, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri ka deklaruar krejt ndryshe duke theksuar i dëmtuari fillimisht e kishte kapë përfytje dhe e ka goditur. Gjykata po ashtu ka vlerësuar se mbrojta e të pandehurit [REDACTED] nuk është e mbështetur në prova dhe fakte, por i njëjti me mbrojtjen e tij është e orientuar nga fshehja e veprimeve inkriminuese me qëllim te shmangies nga përgjegjësia penale.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të pandehurit [REDACTED] i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e ka kryer veprën penale përfytje e cilën është akuzuar, mirëpo një mbrojtje të tillë gjykata e ka vlerësuar si të është pabazuar dhe e njëjtë nuk ka mbështetje në prova dhe fakte, dhe si e tillë më shumë e orientuar ne drejtim te justifikimit te veprimeve të tij inkriminuse, me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe është shumë e qartë se i pandehuri dëshiron t'i shmanget përgjegjësia penale.

Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit [REDACTED] av. [REDACTED] të paraqitura në fjalën përfundimtare se i mbrojturi i tij [REDACTED] ka qenë i provokuar nga i dëmtuari [REDACTED] janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara dhe si të tilla nuk gjithë mbështetje dhe janë kundërshtim të plotë me të gjitha provat e administruara gjatë këtij

shqyrtimi gjyqësor siq janë dëgjimi i dëshmitarit – të dëmtuarit [REDACTED], mbrojtja e të pandehurit [REDACTED] e sidomos edhe nga mbrojtja e të pandehurit [REDACTED] si dhe provat tjera materiale andaj pretendimet e mbrojtësit gjykata i ka vlerësuar në tërësi të paqëndrueshme ngase si të tilla të njëjtat nuk gjejnë asnjë mbështetje në asnjë provë të administruar në shqyrtimin gjyqësor.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 të KPRK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] si rrethana lehtësuese i mori parasysh faktin se tani mes të pandehurve dhe të dëmtuarit nuk ka ndonjë mosmarrëveshje, se i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, e në mungesë të rrethanave rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmérinë konkrete të veprës penale duke i shqiptuar dënim si në dispozitivin e parë të aktgjykimit me bindjen se një dënim i tillë është plotësish i justifikueshëm dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale me bindje se me këtë lloj të dënimit, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

dëmtuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Shtime, ka hek dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Obligohen i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguaj shumën prej 30 /tridhjet/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II

Sa i përket pjesës së dytë të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues Prokurori i Shtetit Mimoza Syla, në fjalën përfundimtare ka dekluaruar se heq dorë nga ndaj të pandehurit [REDACTED] për shkak të veprës penale kanosje nga nen 185 par.1 të KPRK-së, pasi që i dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor ka dekluaruar se e tërheq propozimin per ndjekje penale, andaj bazuar në nenin 185 par.5 të KPRK-së, në mungesë të propozimit pët ndjekje penale ka dekluaruar se tërhiqet nga ndjekja penale ndaj të pandehurit [REDACTED]

I dëmtuari [REDACTED], ka hek dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Në bazë të nenit 450 të KPPK-ës shpenzime sa i përket pjesës nën II të aktgjykimit do të paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, P.nr.1455/15, dt.25.01.2018

Sekretarja Juridike,

Drita Ujupi

Gjyqtari,

Mustaf Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa

Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej

15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.